



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:245446

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05623945

2022:245447

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.K nga Ferizaj, i akuzuar për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.1757/22 të dt.21.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 18.04.2024, me dt.22.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa më datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E.K nga Ferizaj, Rruga "... "..., banesa nr., i lindur më dt...., nga i ati M...dhe e ëma Sh..., e gjinisë R..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i një fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Me datë 17 tetor 2022, rreth orës 18:30, në Kaçanik, seriozisht e ka kanosur me fjalë se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe të dëmtuarit Sh. B., ashtu që pas një mosmarrëveshje që kanë pas

rreth një borgji dhe pas një bisede që kanë pasur përmes rrjetit social “Facebook” i drejtohet me fjalët se “ ... paret ka me ti dhan, po edhe ftyren ka me ta prish”, nga këto fjalë te i dëmtuari ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri.

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro), të cilën I pandehuri është i obliguar që t'a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ne afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendësoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, ndërsa në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari, Sh. B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, urdhërohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën: PP/II.nr.1757/22 të datës 21.11.2022, e akuzoi te pandehurin E.K nga Ferizaj, për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne baze të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.22.03.2023 me te cilin rast palët janë pajtuar që lënda të referohet në procedurë të ndërmjetesimit, mirëpo meqë palët nuk kanë arritur marrëveshje në procedurë të ndërmjetesimit, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e rregullt të lëndës.

Në senacën e vazhduar të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 18.04.2024, prokurori I shtetit Ardian Emini, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

I dëmtuari në fjalën e tij në senacën e shqyrtimit fillestar, i bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shtuar se nuk ka patur ndonjë qëllim që t'a lëndojë të dëmtuarin, dhe këtë e tregon edhe fakti se pas këtij rasti, edhe pse ka patur rast që të takohet me të dëmtuarin, nuk ka patur problem me te, megjithatë meqë i dëmtuari është ndier i kërcënuar nga fjalët e tij, i kërkon falje të dëmtuarit dhe njëherit kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori i shtetit ne fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, pasi që i njëjti është deklaruar vullnetarisht dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret e pranimin të fajësisë dhe ky pranim i fajësisë mbështet edhe në faktet dhe provat mbi bazën të cilave është ngritur aktakuza, dhe nuk ka asnjë rrethanë e cila të pandehurin mund ta përjashtojë nga përgjegjësia penale. Andaj, edhe kërkon nga gjykata që të aprovojë pranimin e fajësisë, të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, duke patur parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri si rrethanë lehtësuese, kurse si rrethanë rënduese te merret parasysh, shqetësimi dhe frika e shkaktuar të dëmtuarit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet ne faktet e çeshtjes qe permban

akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësië për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke i kërkuar falje të dëmtuarit dhe duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë te posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës, i pandehuri ka patur edhe një rast tjetër penal, të identifikuar në SMIL me nr.2022:200250 dhe ate për të njëjtën veprë penale edhe pse rastin në fjalë e ka zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimit, si dhe faktin se i njëjti, gjatë procedurës penale, edhe pse ka ndërruar vendbanimin, nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e re, edhe pse ka qenë në dijeni për procedurën që ka qenë duke u udhëhequr kundër tij, me çka edhe është pamundësuar prezenca e tij në disa seanca gjyqësore.

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin E.K, I akuzuar për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe të mos kryejnë vepra te tilla penale duke ngritur vetëdijësimin per respektimin e ligjit dhe se me këtë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
2022:245447 datë 25.04.2024

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.